# DËSHMI ARKIVI

**A-443346**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Shkollimi kushton deri në 30 mijë lekë në muaj, ekspertja e ekonomisë: Çiftet e reja po e mendojnë dy h erë të kenë fëmijë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/14/shkollimi-kushton-deri-ne-30-mije-leke-ne-muaj-ekspertja-e-ekonomise-ciftet-e-reja-po-e-mendojne-dy-here-te-kene-femije/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 14:00:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 13:56:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 13:55:00 UTC → 14 shtator 2026, 13:57:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `beeef84a7210f0f71924021efe2f62583163b967277e1e35afca478e68865709` |
| TEKSTI | `2e8976bf001aff3e6db3997c9e070cb4977f59b49dc96cfa866c61fdaf65fd9a` |
| PAMJA | `4a8880ad9558d0a66b90c8dd71f979285ff2ff5c313c343651746ee254893719` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bba97dede626d5bc2f882d43dc6ccce81dcb0bcd8dbf38c3201844b3c526469d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6e410cf6c3be6bd40f75161c1288a8066fcd1b6e7ab80a3c789507dd842f2954` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bba97dede626d5bc2f882d43dc6ccce81dcb0bcd8dbf38c3201844b3c526469d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET TË FUNDIT

# Shkollimi kushton deri në 30 mijë lekë në muaj, ekspertja e ekonomisë: Çiftet e reja po e mendojnë dy herë të kenë fëmijë

14/09/2026 15:56



**Edukimi i një fëmije ka një kosto të konsiderueshme për familjet shqiptare.**

Shpenzimet nisin që në klasën e parë me blerjen e librave, të cilët, edhe pse ofrohen falas nga Ministria e Arsimit, shumë prindër preferojnë t'i blejnë në librari, pasi tekstet e ofruara nga shteti janë të plotësuara.
Më pas, shpenzimeve u shtohen mjetet shkollore, veshjet dhe nevoja të tjera që lidhen me shkollimin. Të gjitha këto së bashku bëjnë që kostot për shkollimin të kapin vlerën e 20 mijë lekëve të reja në muaj.
Romina Radonshiqi, eksperte ekonomie thotë: Edhe pse arsimi është falas, në fakt, nëse bëjmë një llogaritje të thjeshtë, mesatarisht për të gjithë Shqipërinë, të dërgosh sot fëmijën në shkollë të kushton rreth 20 mijë lekë të reja në muaj.

Sa më pranë kryeqytetit, aq më të larta janë shpenzimet për edukimin e fëmijës. Në Tiranë, ato mund të arrijnë në rreth 30 mijë lekë në muaj, kryesisht për shkak të kurseve private ato që njihen si afterschool, dhe transportit. Shumë prindër zgjedhin të paguajnë një furgon për lëvizjen e fëmijëve të tyre nga shtëpia në shkollë e më pas në kurs. Shpesh, prindërit detyrohen të paguajnë për orë mësimore shtesë në qendrat private të mësimdhënies, jo vetëm për të përmirësuar rezultatet e fëmijëve, por edhe për shkak të orareve të zgjatura të punës. Për familjet e reja afterschool-i shihet edhe si një vend i sigurt për ku mund të qëndrojë fëmija pas përfundimit të mësimit. Pa folur këtu për aktivitetin e afterschool-it, fëmijët kanë nevojë për mësime shtesë, ndërsa prindërve u duhet të punojnë me orare të zgjatura për të siguruar këto kosto të larta.

Sipas ekspertes së ekonomisë, kur krahasohen kostot e jetesës me nivelin e pagave, një pjesë e madhe e të ardhurave familjare shkon për rritjen, edukimin dhe ushqyerjen e një fëmije. Janë faturat e kripura të edukimit dhe argëtimit ato që po sjellin familje të vogla.

Ekspertja sqaron ndër të tjera: Nëse krahasojmë koston e jetesës me nivelin e pagave, atëherë një pjesë e konsiderueshme e pagës shkon për rritjen e një fëmije, që do të thotë rritje, edukim dhe ushqyerje. Kjo është edhe arsyeja përse çiftet e reja po e mendojnë dy herë vendimin për të bërë një fëmijë.

Për herë të parë qeveria shqiptare do të aplikojë programin " Pas Shkolle" në 408 shkolla, në të cilën do të zhvillohen aktivitete të ndryshme nga " Bëjmë detyra e shtëpisë e deri tek orët zbavitëse të muzikës, zejtarisë e sporteve. Sipas Ministrisë së Arsimit ky program nuk ka për qellim ruajtjen e fëmijëve deri sa prindërit të dalin nga puna, por edhe zhvillimin social dhe kulturorë.

**Top Channel**

## Aktualitet »

## Kryesore



25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"
15:17

Bllokuan akset kryesore të Tiranës gjatë tubimit të djeshëm, procedohen penalisht 20 protestues
11:32

E rëndë në Roskovec/ Theu urdhrin e mbrojtjes dhe shkoi në banesën e ish-partneres, 59-vjeçari plagos me drapër ish-vjehrrin
12:10

Trump paralajmëron fundin e luftës në Iran: Mund të ndodhë rreth zgjedhjeve amerikane
07:48

Premier League pranon gabimin: Goli i Haaland ndaj Manchester United nuk duhej të ishte quajtur i rregullt
11:22

## Më të lexuarat

Exclusive/ "Rastësia që më lidhi me Artur Zhejin", rrëfehet për herë të parë bashkëshortja e publicistit: Kam dashur vetëm ta ndjek dhe ta adhuroj

E ndoqi në hotel dhe u larguan së bashku nga klubi i natës, 17-vjeçarja gjermane shokon: Më duket se më përdhunoi një burrë 10 vite më i madh

Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, si ndodhi sherri në plazhin grek, shqiptari zhduket nga vendngjarja pas të shtënave

Kishte dalë me leje nga burgu, "tmerri" i policisë greke Alket Rizai hap zjarr në lokal pas sherrit për muzikën, disa të plagosur

"Nuk po na lejohet të marrim nga qesja jonë"/ Rama i përgjigjet gjyqtarit: E pabesueshme që e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar

Ekskluzive/ Ilir Meta del nga kafazi! Gjykata e Apelit pranon kërkesën e ish-presidentit, do të qëndrojë pranë avokatit

"Një nga mendjet më të ndritura që kishim"/ Nga Grida Duma te Spartak Ngjela dhe Rajmonda Bulku, miqtë kujtojnë Artur Zhejin në 'Exclusive'

Alket Rizai shpallet në kërkim në Greqi, duhej të kthehej në burg në orën 8:00 pas incidentit në lokal



14 shtatori pa zilen e shkollës/ Fshati Neviçisht pranë Korçës zbrazet nga shpopullimi, nuk ka më asnjë nxënës

14/09 15:44



Mesazh kërcënues në rrjet social ndaj një 34-vjeçari në Tiranë, policia referon çështjen në Prokurori, nis hetimet për identifikimin e autorit

14/09 15:42



25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"

14/09 15:17



Ekskluzive/ Ilir Meta del nga kafazi! Gjykata e Apelit pranon kërkesën e ish-presidentit, do të qëndrojë pranë avokatit

14/09 14:57



Video/ Polici goditi me grusht në bark qytetarin në protestë, Skënder Hita pezullon efektivin e "Shqiponjave"

14/09 14:38



"Veliaj duhet të lirohet"/ Valteri në Shqipëria Live: Hetimi ka një vit që është mbyllur, Tirana ka nevojë për kryebashkiakun

14/09 14:25

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »




Top Channel/ Meta del nga kafazi, Do ndjekë gjyqin për masën e sigurisë përkrah avokatit



Top News – 'Ndjek me kënaqësi zhvillimet…'/ Berisha flet për vizitën në SHBA dhe…Ballukun



Top News-Regjistrimet në Universitetin Mesdhetar/Revolucion kurrikular, programe me mundësi punësimi



Top News- Rregullorja anti-media bllokon GJKKO! Shtyhen seancat, gjyqtarët me celularë në sallë



Top Channel/ Alket Rizai ikën sërish nga burgu, ishte me leje, përfshihet në të shtëna në Athinë



Top Channel/ 41 kg kokainë në port, droga me vlerë 2 milionë euro u gjet në kontejnerin e mishit

'E zhdukur' prej tri ditësh/ Zbulohen detaje tronditëse për fatin e foshnjës 11-muajshe në Turqi: I ati e shiti në këmbim të parave

Video/ Polici goditi me grusht në bark qytetarin në protestë, Skënder Hita pezullon efektivin e "Shqiponjave"



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.